

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. J. nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2350-4/2016 të datës 29.12.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Fatos Ajvazi, të akuzuarit dhe përkatës të gjykatës Violeta Celina, me datë 15.12.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. J. nga i ati Sh. dhe e ëma A. e lindur Xh., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren tani me banim në fshatin L. Komuna e Prizreni, ka të kryer shkollën fillore, autolimar, i martuar, baba i një fëmije, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 14.08.2016 rreth orës 18:14 minuta, në rrugën ..., si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, nuk i përmbahet dispozitave të komunikacionit, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, shkel ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 150 të LSKRR, duke e drejtuar automjetin e markës “Opel Corsa”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, me ngjyrë të bardh, kurrë arrin në vendin kritik në afërsi të furrës “A.”, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk i përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë si dhe nuk i kushton kujdes të duhur këmbësorëve, derisa i dëmtuari ka qenë duke kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë në drejtim të lëvizjes së automjetit, me rrotën e përparme të anës së majtë të automjetit shkel këmbën e djathtë të dëmtuarit H. Ç., me ç’rast me këto veprime shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje dhe gërvishje në shputën e këmbës së djathtë, lëndime të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupore.

Këso dore kryen veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M M E K U S H T

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari H. (E.) Ç. nga Prizreni rruga ... nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të shpenzimeve të ekspertit të komunikacionit për ekspertizës shumë prej 40.88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë në shumë prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2350-4/2016 të datës 29.12.2016, kundër të akuzuarit F. J. nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit, i njëjti u deklarua se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 14.08.2016 rreth orës 18:14 minuta, në Prizren në rrugën ..., i akuzuari F. J. si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, gjatë drejtimit të automjetit të markës “Opel Corsa” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, kur arrin në vendin kritik në afërsi të furrës “A.”, nga pakujdesia shkel ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 150 të LSKRR, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk i përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë, nuk i kushton kujdes të duhur këmbësorëve, i dëmtuari derisa ka qenë duke kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë në drejtim të lëvizjes së automjetit, me rrotën e përparme të anës së majtë të automjetit shkel këmbën e djathtë të dëmtuarit H. Ç., me ç’rast me këto veprime shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje dhe gërvishje në shputën e këmbës së djathtë, lëndime të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupore.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale siç janë ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ing. S. Sh. të datës 25.10.2016, ekspertiza e ekspertes së mjekësisë ligjore Dr. M. G. të datës 03.11.2016, raporti mjekësor nga Qendra Emergjente në Prizren me numër të protokollit 7389 të datës 14.08.2016, skica e vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në këtë mënyrë edhe është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, prandaj edhe në

veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht, duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë, rrethanat familjare të akuzuarit, është mbajtës i vetëm i familjes, është i gjendjes së varfër ekonomike, gjer më tani nuk ka qenë i gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoj dënimin me kushte sepse konsideron se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2837/2016 të datës 15.12.2017

**Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja
Teuta Krusha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.